



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1658/12 Prot.

Tiranë, më 08.09 2026

V E N D I M

Nr. 117 datë 08.09 2026

“PËR
MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË TARIFËS SË VETME TË REGJISTRIMIT PËR
KONKURS, NË DY PROGRAMET BACHELOR NË FVFR, NË UNIVERSITETIN
E SPORTEVE TË TIRANËS PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027”

Në zbatim të Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH pika 3, gërma ç), të nenit 3, nenit 6, pika 28, nenit 38, nenit 83, të nenit 109, pika 1, të Statutit të UST, të Rregullores së UST, si dhe bazuar në kërkesën e Dekanit të FVFR shkresë me nr. 1627 prot., datë 02.09.2026 “Kërkesë për përjashtim nga pagesa e dyfishtë e tarifës për kandidatët që konkurojnë njëkohësisht në dy programe “Bachelor” të ofruara nga FVFR”, në Vendimin e Rektoratit me nr. 107 datë 04.09.2026, Senati Akademik në mbledhjen e datës 08.09.2026,

V E N D O S I:

1. Të miratojë propozimin, që studentët që konkurojnë në dy programet Bachelor në FVFR, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, t'i nënshtrohen një tarife të vetme prej 5,000 (pesëmijë lek), lidhur me regjistrimin në konkursin praktik të aplikantëve.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. AGRON KASA

